



**RAPORTI
STATISTIKOR
JANAR - KORRIK
2022**

Hyrje

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të tregut të sigurimeve dhe më pas të shoqërisë Insig Jetë për periudhën janar-korrik 2022. Të dhënat paraqiten të krahasuara me të njëjtën periudhë të vitit 2021, si edhe për tregues specifik të dhënat krahasohen për periudhën janar-korrik të viteve 2018 - 2022.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë Buletini Statistikor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare janar-korrik 2022 dhe të dhëna të tjera nga burimet e shoqërisë Insig Jetë.

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Korrik 2022	4
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës	4
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jetës	7
2. Primet e shkruara bruto për shoqërinë Insig Jetë, Janar-Korrik 2022	8
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të jetës së debitorit	9
2.2 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	9
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig Jetë, Janar-Korrik 2022	11


1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Korrik 2022

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-korrik 2022 ka realizuar **11,866,537,830 lekë** prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës dhe Jo Jetës, duke shënuar rritje me 8.51 % krahasuar me muajt janar-korrik 2021. 91.54 % të këtyre primeve realizohet nga sektori i Jo Jetës, pjesa tjetër prej 8.36 % nga sektori i Jetës, kurse veprimtaria e risigurimeve primet e realizuara janë vetëm 0.10 % e totalit. **Vlera e dëmeve të paguara** nga industria e sigurimeve është **3,702,897,364 lekë** në rënie 12.77 % krahasuar me muajt janar-korrik të vitit 2021. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 90.66 % e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 4.28 % e tyre nga aktiviteti i Jetës dhe 5.06 % nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës

Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jetës është 991,717,680 lekë duke shënuar rritje me 25.15 % krahasuar me janar-korrik të vitit 2021, tregues pozitiv për aktivitetin e Jetës. Kontributin më të madh në rritjen e këtij treguesi e jep klasa e sigurimit të jetës së debitorit me 19.55% rritje në krahasim me janar-korrik 2021, për shkak të përpjesës së madhe ndaj totalit që ky lloj sigurimi ka. Për periudhën referuese rritjen më të madhe e mban lloji i **sigurimit jetë dhe shëndeti në udhëtim**, ndërsa llojet e sigurimeve jeta e kombinuar, jeta e nxënësit dhe studentit dhe jetë me kursim janë në rënie. Të dhënat janë të paraqitura si në grafikun 1. Me rritje paraqitet edhe numri i kontratave të lidhura, rreth 30.16% më shumë, duke u nënshkruar 72,504 kontrata.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar-korrik 2022/2021




Burimi: AMF, përpunoi autori

Ndërkohë në një analizë të ecurisë së primeve të shkruara bruto të periudhës janar-korrik për vitet 2018-2022 për tregun e Jetës, **vihet re tendencë kryesisht në rritje e primeve të shkruara bruto**. Viti 2020 shënon vlerën më të ulët të primeve të realizuara të pesë vjeçarit, si pasojë e Covid-19. Gjatë janar-korrikut të vitit 2022, primet rriten me rreth 25.15% krahasuar me vitin 2021, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020

rritja është afro 70.21%. Dukuri pozitive është fakti, se **vlera më e lartë e primeve të realizuara është në periudhën janar-korrik 2022.**


Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto, janar-korrik 2018-2022 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori

Tregu i sigurimeve të Jetës vijon të mbizotërohet nga lloji i sigurimit jetë debitor, i cili në raport me totalin e primeve të grumbulluara mban afro 63.93% të saj. Llojet e sigurimeve të jetës më kursim zënë 9.51% të totalit, më pas flexi plan me afro 7.10% ndërsa pjesa tjetër e ndarë sipas grafikut 3.

Grafiku 3: Përpjesa e primeve bruto sipas të llojit të sigurimeve ndaj totalit, janar-korrik 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jetës gjatë periudhës janar-korrik 2022 është 72,504 kontrata, duke shënuar rritje prej 27.78 % më shumë se një vit më parë. Ashtu si edhe në volumin e primeve të shkruara, pjesën kryesore e zënë kontratat e Jetës së Debitorit me 64 % të numrit total. Në termat e primeve të shkruara bruto tregu dominohet

nga shoqëria Sigal Life e cila zotëron afro 46.96 % të tregut të Jetës, ndjekur nga Insig Jetët me rreth 19.61% (vendi dytë), Sicred 17.70 % (vendi i tretë) dhe Albsig Jetë 15.74 % (vendi i katërt).


Grafiku 4: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jetës, janar-korrik 2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Ndërkohë norma e rritjes së tregut është 25.15 % krahasuar me janar-korrik 2021, shoqëria me rritjen më të madhe është Albsig Jetë, me normë rritje 75.83 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Grafiku 5: Norma e rritjes së primit, janar-korrik 2022/2021




Burimi: AMF, përpunoi autori

1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jetës

Gjatë periudhës janar-korrik 2022 nga aktiviteti i sigurimit të Jetës janë paguar 134,653,536 lekë dëme, shifër në rënie krahasuar me janar-korrik 2021, 36.12% më pak dëme të paguara, kjo për shkak të vlerës së lartë të dëmeve të paguara në vitin 2022.


Grafiku 7: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar-korrik 2018-2022



Burimi: AMF, përpunoi autori

Siç ilustron dhe në grafikun 7, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është në periudhën janar-korrik të vitit 2021 për gjithë periudhën e pesë vjeçarit, ardhur kryesisht nga dëmet që solli pandemia globale COVID 19. Ndërkohë, për muajt janar-korrik 2022 në ndryshim nga vlera e paguar e dëmeve, numri i dëmeve të paguara rritet me 17.97%, duke u rritur frekuenca e pagesës së dëmeve. Një pjesë e mirë e llojeve të sigurimit pësojnë rënie krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ndërkohë sigurimet jetë dhe shëndet në udhëtim, jetë në grup janë me rritje, por përpjesa e tyre në totalin e dëmeve është shumë e vogël.


Grafiku 8: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, janar-korrik 2022/2021



Burimi: AMF, përpunoi autori

Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara nga shoqëritë e sigurimit që operojnë në tregun e Jetës, paguhen nga Sigal Life rreth 48.49% e tyre, më pas Sicred me rreth 32.54% të dëmeve të paguara të tregut, Insig Jetë me 17.67% dhe së fundi Albsig Jetë më 1.31%. Ilustrimet grafike paraqiten në grafikun 9.

Grafiku 9: Ndarja e tregut të sigurimeve të Jetës për dëmet e paguara, janar-korrik 2022




Burimi: AMF, përpunoi autori

2. Primet e shkruara bruto për shoqërinë Insig Jetë, Janar-Korrik 2022

Gjatë periudhës janar-qershor 2022 shoqëria Insig Jetë realizoi 194,494,500 lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar një rritje afro 65% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Rritja është afro 39.79 % më shumë se tregu, ndërsa pozicioni i klasifikimit renditet i dytë në treg, duke u ngritur në klasifikim krahasuar me pozicionin që mbante deri në gjshtëmuor. Ecuria e primeve të shoqërisë Insig Jetë nga viti 2018 deri në vitin 2022 paraqitet e luhatshme, duke shënuar rritjen më të madhe nga viti 2018 në vitin 2019, më pas në vitet 2020-2021-2022 situata paraqitet me rritje dhe rënie në intervalet -24% deri në +65%, **megjithatë vlera më e lartë e primeve të realizuara rezulton në vitin 2022**, duke vijuar me ritëm të vazhdueshëm rritje që nga viti 2020.

Grafiku 10: Ecuria e primeve të shkruara bruto për Insig Jetë, janar-korrik 2018-2022 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori

2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të jetës së debitorit

Gjatë periudhës janar-korrik të vitit 2022, nga klasa e sigurimit të jetës së debitorit janë grumbulluar 76,269,051 lekë prime të shkruara bruto ose rreth 22.57% më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2021, ndërkohë tregu rritet me 18.55 %. Pjesa më e madhe e primeve të grumbulluar vjen nga kjo klasë sigurimi, duke bërë që përpjesa e tyre ndaj totalit të jetë rreth 39.21%. Ndërkohë në treg Insig Jetë për këtë klasë sigurimi mban 12.02 % të totalit të tregut, renditur në vend të tretë, pothuajse e njëjta përpjesë që zotëronte edhe në të njëjtën periudhë të vitit 2021. Grafiku 14 ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për muajt janar-Korrik të pesë vjeçarit 2018 – 2022. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet në vitin 2018, ndërsa më e lartë në vitin 2022.

Grafiku 11: Primet e shkruara bruto Insig Jetë për klasën jetë debitori, janar-korrik 2018-2022 (mijë lekë)




Burimi: Të dhëna Insig Jetë, përpunoi autori

2.2 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Pjesa tjetër e primeve të realizuara nga shoqëria Insig Jetë përbëhet nga klasat; jeta e nxënësit dhe studentit; jeta në grup; jeta dhe shëndeti flexi plan; jeta dhe shëndeti në udhëtim dhe së fundi jetë dhe shëndeti i studentit. Ndër to përpjesën më të madhe e zotëron klasa e sigurimit të jetës dhe shëndetit flexi plan, duke zotëruar 48.47% të totalit të primeve për janar-korrik 2022. Kjo e fundit, vlerën më të lartë të primeve të grumbulluara e ka në periudhën janar-korrik të vitit 2022, për pesë vjeçarit 2018-2022. E ndjekur më pas nga klasa e sigurimeve të jetës në grup, të cilat në raport me totalin përbëjnë 10.79% të tyre për janar-korrikun e vitit 2022, krahasuar me periudhën janar-Korrik 2021 primet rezultojnë me rritje prej 67.40% dhe vlerën më të lartë e arrin në vitin 2018 për gjithë periudhën e pesë vjeçarit. Ndërkohë pjesa tjetër e primeve realizohet nga llojet e tjera të sigurimeve, të cilat në total përbëjnë 1.53% të tyre. Të përmbledhura grafikisht paraqiten të dhënat për klasat e tjera të sigurimit sipas grafikut 12.

Grafiku 12: Ecuria e primeve të Insig Jetë për klasat e tjera, janar-korrik 2018-2022 (mijë lekë)



Burimi: Të dhëna Insig Jetë, përpunoi autori

Në përmbledhje të të gjitha llojeve të sigurimit që shoqëria Insig Jetës ofron për tregun e sigurimeve të Jetës paraqitet tabela 1, e cila përmbledh ndryshimet që kanë pësuar llojet e sigurimeve të krahasuara me vitin 2021. Sipas tabelës, krahasuar me janar-korrik të vitit 2021, sigurimet e jetës dhe shëndetit të studentit, dhe jeta e nxënësit e studentit janë me rënie, ndërsa pjesa tjetër shënon rritje, duke sjellë një rritje të përgjithshme të shoqërisë me 65%.

Tabela 1: Primet e shkruara bruto Insig Jetë, janar-korrik 2022/2021 (mijë lekë)


Lloji I sigurimt	Janar-korrik 2021	Janar-korrik 2022	Ndryshimi ne % ndaj totalit	Ndryshimi ne % 22/21
1-sigurimi i jetes debitorit	62,225,679	76,269,051	39.21%	22.57%
2-sigurimi i jetes dhe shendetit te studentit	188,932	131,227	0.07%	-30.54%
3-sigurimi i jetes dhe shendetit ne udhetim	2,136,849	2,801,126	1.44%	31.09%
4-sigurimi i jetes dhe shendetit flexi plan	40,771,351	94,277,072	48.47%	131.23%
5-sigurim jete ne grup me AP	12,531,692	20,977,664	10.79%	67.40%
6-sigurimi i jetes nxenes dhe studenti	64,672	38,360	0.02%	-40.69%
Totali	117,919,175	194,494,500	100.00%	

Burimi: Të dhëna Insig Jetë

3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig Jetë, Janar-Korrik 2022

Gjatë periudhës janar-qershor 2022, totali i dëmeve të paguara nga shoqëria Insig Jetë është 26,919,678 lekë, në rënie me 28.92%, krahasuar me nivelin e dëmeve të paguara të periudhës janar-korrik 2021. Ndërkohë numri i dëmeve të paguara është në rritje afro 38.4% duke u paguar kështu 778 dëme. Raporti dëme/prime për janar-korrik 2022 rezulton të jetë 13.84%, rreth 2.14% më pak se raporti i tregut. Në raport me totalin e dëmeve të paguara të tregut, shoqëria Insig Jetë paguan 16.98 % të tyre. Siç u theksua, vlera e dëmeve të paguara nga tregu pëson rënie me më shumë se 29.46% %, ndërkohë shoqëria Insig pëson rënie me 28.92%, në njëjtë nivele si tregu. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vijnë nga mbulimet që ofron sigurimi i jetës dhe shëndetit flexi plan 67.26%, më pas klasa e sigurimeve të jetës së debitorit 22.49%, jetë në grup 10.25% dhe së fundi të tjerat.

Grafiku 13: Pjesa e dëmet e paguara nga llojet e sigurimit Insig Jetë, janar-korrik 2022




Burimi: Të dhëna Insig Jetë, përpunoi autori

Ecuria e dëmeve të paguara për periudhën janar-korrik gjatë viteve 2018 – 2022 paraqitet kryesisht e ndryshueshme. Viti 2019 mban dhe vlerën më të lartë të dëmeve të paguara të pesë vjeçarit, ndërsa raporti më i lartë dëme/ prime shënohet në vitin 2021. Për vitin 2021, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara vjen si pasojë e mbulimeve që ofron sigurimi i jetës së debitorit, më pas jetë dhe shëndeti flexi plan.

Për klasën e sigurimit jetë e debitorit, vlera e dëmeve të paguara nga Insig është 6,054,308 lekë, të cilat përbëjnë 8.17% të dëmeve të paguara të tregut për këtë lloj sigurimi dhe me rënie afro 73.04% krahasuar me janar-korrik 2022. Ndërkohë, tregu pëson rënie në masën e dëmeve të paguara nga ky lloj sigurimi me 51.09%.

Grafiku 14: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig Jetë, janar-korrik 2018-2022 (mijë lekë)



Burimi: AMF, përpunoi autori